

 Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosova		
ZYRA RREGULLATORE PËR UJËSJELLËS DHE KANALIZIM REGULATORI URED ZA VODU I KANALIZACIJU WATER AND WASTEWATER REGULATORY OFFICE		
Nr. Pro/L/Prot. Dr. Pro/L. No. _____ Njësia/Unitet/Div. _____ Nr. Shkres. Urdh. Dr. /Urdh. No. _____ Datë/Date/Date _____	552 01 29.12.2014	ZRRUK/UTSH-07/06/2014 29 Dhjetor 2014

Në pajtim me autoritetin e dhënë me *Ligjin Nr. 03/L-086, mbi Veprimtaritë e Ofruesve të Shërbimeve të Ujësjellësit dhe Kanalizimit*, të datës 13 Qershor 2008 me të cilën është amendamentuar *Rregullorja 2004/49 ("Ligji")*.

Konform Nenit 15. të *Rregullës për Përcaktimin e Tarifave të Shërbimeve të Ujësjellësit, Kanalizimit dhe të Furnizimit të Ujit me Shumicë në Kosovë* të datës 24 Dhjetor 2012 (Rregulla ZRRUK R-02/U&K),

Duke u bazuar në të dhënat e aplikacionit për Tarifa Shërbimi të dorëzuara nga KUR "Hidromorava" Sh. A., dhe në procesin e zhvilluar të analizave dhe të vlerësimit të tyre,

Zyra Rregullatore për Ujësjellës dhe Kanalizim ("ZRRUK") lëshon këtë:

URDHËRESË PËR TARIFA SHËRBIMI

PËR PËRCAKTIM TË TARIFAVE PËR SHËRBIMET E UJËSJELLËSIT DHE KANALIZIMIT QË DUHET TË APLIKOHEN NGA KUR "HIDROMORAVA" SH. A. GJILAN PËR VITIN 2015 NGA PERIUDHA TARIFORE 2015-2017

1. Interpretimi

Në këtë Urdhëresë të Tarifave të Shërbimit (UTSH), përveç nëse konteksti e kërkon ndryshe, fjalët dhe shprehjet me shkronja të mëdha do të kenë kuptimin që u atribuohen Rregullës ZRRUK R-02/U&K.

2. Zbatueshmëria

Kjo Urdhëresë e Tarifave të Shërbimit është e zbatueshme dhe e detyrueshme për KUR "HIDROMORAVA" Sh. A., me rastin e faturimit të Shërbimeve të Ujësjellësit dhe Kanalizimit që u ofron konsumatorëve të vet në tërë Zonën e saj të shërbimit.

ZRRUK mund t'i bëjë korrigjimet e rregullta dhe të jashtëzakonshme të tarifave të shërbimit në bazë të kërkesës së KUR "Hidromorava" Sh. A. në pajtim me nenin 16. të Rregullës ZRRUK R-02/U&K.

3. Përmbajtja e shtojcave të kësaj UTSH-ëje

Shtojcat e kësaj Urdhërese Tarifore të Shërbimit përmbajnë;

- 3.1 *Shtojca Nr. 1: Lista e Tarifave të Shërbimit, me sqarimet përkatëse, dhe*
- 3.2 *Shtojca Nr.2: Caqet operative, financiare dhe ato të investimeve kapitale të përcaktuara për t'u arrit nga kompania gjatë vitit 2015.*

Tarifat e përcaktuara në këtë UTSH janë pa TVSH.

4. Afati

Tarifat e përcaktuara me këtë Urdhëresë të Tarifave të Shërbimit do të jenë të zbatueshme për periudhën **1 janar 2015 deri më 31 dhjetor 2015**, nga procesi rregullator i tarifave të periudhës 2015-2017.

5. Publikimi dhe Shpërndarja e Listës së Tarifave të Shërbimit

- 5.1 KUR "HIDROMORAVA" Sh. A. duhet të shpërndajë Listën e Tarifave të Shërbimit të aprovuara me këtë Urdhëresë të Tarifave të Shërbimit, tek secili Konsumator në momentin e nënshkrimit të Kontratës për Shërbime ose së paku një herë në fillim të aplikimit të saj t'i bashkëngjis të njëjtën faturës me të cilën faturohen konsumatorët.
- 5.2 Lista e Tarifave për Shërbime e aprovuar nga ZRRUK nën këtë Urdhëresë të Tarifave të Shërbimit duhet të publikohet nga KUR "HIDROMORAVA" Sh. A., së paku në njërën prej gazetave ditore me tirazh gjithë përfshirës në tërë Kosovën, brenda shtatë (7) Ditëve të Punës, pas shpalljes dhe publikimit të saj nga ZRRUK në portalin e internetit të vet; www.wwro-ks.org.

6. Apelet

KUR "HIDROMORAVA" Sh. A. ka të drejtë të apelojë këtë urdhëresë ose pjesë të saja brenda 15 ditëve të punës nga data e publikimit, tek Komisioni Shqyrtues i themeluar konform nenit 34. Komisioni Shqyrtues, pika 34.1., Ligji Nr. 03/L-086 mbi Veprimtaritë e Ofruesve të Shërbimeve të Ujësjellësit dhe Kanalizimit, të datës 13 Qershor 2008.

7. Gjuhët Zyrtare të Urdhëresës për Tarifa Shërbimi

Kjo Urdhëresë për Tarifa të Shërbimit publikohet në tri (3) gjuhë, dy nga të cilat janë zyrtare që përdoren në Kosovë dhe në Gjuhën Angleze.

Në rast mospërputhje në mes të versioneve të UTSH-ës, do të mbizotërojë versioni i shkruar në gjuhën Shqipe.




Raif Preteni
Drejtor i ZRRUK

SHTOJCA 1: LISTA E TARIFAVE TË SHËRBIMIT**1. Tarifat Fikse dhe Tarifat Volumetrike për Shërbimet e Ujësllësit dhe Kanalizimit***Afati i Aplikueshmërisë: 1 janar 2015 – 31 dhjetor 2017*

Kategoria e Konsumatorëve	Tarifa Fikse (EURO/muaj)	Tarifa Volumetrike për Shërbime të Ujësllësit (EURO/m ³)	Tarifa Volumetrike për Shërbime të Kanalizimit (EURO/m ³)
1.1. TARIFAT PA INFLACION TË PËRCAKTUARA PËR VITIN 2015 (1 JANAR 2015 – 31 DHJETOR 2015)			
Shtëpiak	1.0	0.3300	0.0745
Institucional dhe Industrial/Komercial	3.0	0.6435	0.1938
1.1. TARIFAT E APLIKUESHME PËR VITIN 2015 JANË PËRCAKTUAR MBI BAZËN E INDEKSIT TË PROJEKSIONEVE TË ÇMIMEVE TË KONSUMIT TË PUBLIKUARA NGA FMN PËR VITIN 2014 Të aplikueshme nga (1 JANAR 2015 – 31 DHJETOR 2015)			
Shtëpiak	1.0	0.33	0.08
Institucional dhe Industrial/Komercial	3.0	0.65	0.20
2.1. TARIFAT PA INFLACION TË PËRCAKTUARA PËR VITIN 2016 (1 JANAR 2016 – 31 DHJETOR 2016)			
Shtëpiak	1.0	0.3242	0.0737
Institucional dhe Industrial/Komercial	3.0	0.6290	0.1915
2.2. TARIFAT E APLIKUESHME PËR VITIN 2016 MBI BAZËN E INDEKSIT TË ÇMIMEVE TË KONSUMIT TË PUBLIKUARA NGA ASK PËR PERIUDHËN 12/2014-11/2015 (1 JANAR 2016 – 31 DHJETOR 2016)			
Shtëpiak	1.0		
Institucional dhe Industrial/Komercial	3.0		
3.1. TARIFAT PA INFLACION TË PËRCAKTUARA PËR VITIN 2017 (1 JANAR 2017 – 31 DHJETOR 2017)			
Shtëpiak	1.0	0.3186	0.0725
Institucional dhe Industrial/Komercial	3.0	0.6180	0.1886
3.2. TARIFAT E APLIKUESHME PËR VITIN 2017 MBI BAZËN E INDEKSIT TË ÇMIMEVE TË KONSUMIT TË PUBLIKUARA NGA ASK PËR PERIUDHËN 12/2015-11/2016 (1 JANAR 2017 – 31 DHJETOR 2017)			
Shtëpiak	1.0		
Institucional dhe Industrial/Komercial	3.0		

Sqarim:

- Për vitin 2015 tarifat e aplikueshme për konsumatorë, janë ato me inflacion, pika 1.2.
- Tarifat e aplikueshme për konsumatorë për vitin 2016 pika 2.2. do të përcaktohen në bazë të lëvizjes së Indeksit të Çmimeve të Konsumit në Kosovë të publikuara nga ASK për periudhën Dhjetor/2014 – Nëntor/2015.
- Tarifat e aplikueshme për konsumatorë për vitin 2017 pika 3.2. do të përcaktohen në bazë të lëvizjes së Indeksit të Çmimeve të Konsumit në Kosovë të Publikuara nga ASK për periudhën Dhjetor/2015 – Nëntor/2016.
- Tarifat fikse edhe ashtu nuk i nënshtrohet rregullimit për inflacion gjatë viteve.

ASK – Agjencia e Statistikave të Kosovës

IÇK – Indeksi i Çmimeve të Konsumit

FMN – Fondi Monetar Ndërkombëtar

2. Tarifat për administrim dhe shpenzimet për kyçje në Rrjetin e Shërbimeve të Ujit

Afati i Aplikueshmërisë: 1 janar 2015 – 31 dhjetor 2015

2.1. Tarifa Administrative për Kyçje në Shërbime*	Diametri i gypit të kyçjes/ujëmatësi	Tarifa për kyçje në ujë (€)	Tarifa për kyçje në kanalizim (€)	Shuma (EURO)
Për të gjitha Kategoritë e Konsumatorëve <i>(*) –Tarifa për administrim është e pakthyeshme dhe nënkuptojmë të drejtën e konsumatorit për tu kyç në rrjetin e shërbimeve të ujit dhe mbajtjen e tij në regjistrin e konsumatorëve aktiv për çështje të ndryshme administrative. Shumat e inkasuara për këtë destinim përdoren për zgjerimin e rrjetës së shërbimeve të ujit.</i>	(13 – 25) mm	30.00	20.00	50.00
	32 mm	90.00	60.00	150.00
	40 mm	150.00	100.00	250.00
	50 mm	240.00	160.00	400.00
	65 mm	300.00	200.00	500.00
	80 mm	420.00	280.00	700.00
	100 mm	570.00	380.00	950.00
	150 mm	840.00	560.00	1,400.00
2.2. Shpenzimet e Kyçjes në Shërbime të Ujësjiellësit*	Diametri i gypit të kyçjes/ujëmatësit			Shuma (EURO)
Për të gjitha Kategoritë e Konsumatorëve <i>(*) - Shpenzimet e Kyçjes në Shërbime përfshijnë shpenzimet e punës dhe materialit në vijim: qafore, pajisjet për kyçje, gypat e kyçjes në gjatësi deri 15 metra, ujëmatësi dhe dy valvula. Punët tokësore dhe ato të betonit nuk janë të përfshira.</i>	(13 – 20) mm			120.00
	(25 – 32) mm			160.00
	(40 – 50) mm			220.00
	> 50mm			Do të llogaritet në bazë të çmimeve për material dhe punën.
2.3. Shpenzimet e Kyçjes në Shërbimet e Kanalizimit *	Diametri i gypit të kyçjes/ujëmatësit			Shuma (EURO)
Për të gjitha Kategoritë e Konsumatorëve <i>(*) – Shpenzimet e Kyçjes në Shërbime përfshijnë shpenzimin e punës dhe të materialit në vijim: elementet fazonike për kyçje dhe gypit në gjatësi deri 15 metra. Punët tokësore dhe ato të betonit nuk janë të përfshira.</i>	DN 110 mm			100.00
	DN 160 mm			120.00
	DN 200 mm			160.00
	> 200 mm			Do të llogaritet në bazë të çmimeve për material dhe punën.

3. Tarifat për Shërbimet Tjera

Afati i Aplikueshmërisë: 1 Janar 2015 – 31 Dhjetor 2015

Lloji i Shërbimit	Shuma (EURO)
3.1. Dërgimi i njoftimit për shkyçje llogaritet vetëm njëherë pas dërgimit të njoftimit të dytë brenda vitit kalendarik, sipas Ligjit Nr 03/L-086, Neni 28 pika 28.1 (i) dhe Rregullores ZRRUK R-04/U & K, neni 32.1 (b) të datës 16.07.2010	3.00
3.2. Shkyçja e Shërbimeve të Ujësjiellit	20.00
3.3. Rikçja e Shërbimeve të Ujësjiellit	20.00
3.4. Riparimi i rrjedhjeve në objektin e Konsumatorit	Duhet të llogaritet në bazë të çmimeve për material dhe punën.
3.5. Gjoha për kyçje ilegale	100.00
3.6. Gjoha për moskryerje të riparimit të rrjedhjes në objektin e konsumatorit aplikohet pas vërejtjes së parë	100.00
3.7. Shitja e ujit me cisterna të ujit – transporti deri në 5 km	20.00 EURO/5m3
3.8. Riparimi i ujëmatësit nga çmimi i ujëmatësit kur kompania e instalon ujëmatësit e saj	Max. 60% të çmi mit të ujëmatësit
3.9. Kontrollimi i ujëmatësit – verifikimi i saktësisë	15.00

Disa nga aspektet e këtyre shërbimeve janë të rregulluara edhe me Rregullën ZRRUK R-03/ U & K.

SHTOJCA 2: CAQET OPERATIVE, FINANCIARE DHE ATO TË INVESTIMEVE KAPITALE TË PËRCKTUARA PËR TU ARRIT NGA KOMPANIA GJATË VITIT 2015

Këto caqe paraqesin obligim kontraktual ndërmjet KRU-së dhe ZRRUK-ut për t'u përmbush gjatë vitit kalendarik biznesor 2015 me përshtatjet e bëra për lëvizjet inflatore të periudhës së caktuar.

Caqet e aprovuara për përmbushje gjatë vitit 2014	Njësia	Viti 2015
Të dhënat operative		
1.1 Uji i prodhuar	m ³ /vit	7,733,190
1.2 Uji i humbur	m ³ /vit	3,797,000
1.3 Uji i faturuar	m ³ /vit	3,936,190
1.4 Numri i konsumatorëve	Nr	23,621
Të dhënat financiare		
2.1 Shpenzimet operative për shërbimet e ujit	€/vit	1,131,468
2.2 Shpenzimet operative për shërbimet e kanalizimit	€/vit	105,642
2.3 Shuma vjetore e shpenzimeve operative	€/vit	1,237,110
2.4 Faturimi për shërbimet e ujësjellësit	€/vit	1,789,523
2.5 Faturimi për shërbimet e kanalizimit	€/vit	273,244
2.6 Shuma e faturimit për dy shërbimet	€/vit	2,062,767
2.7 Arkëtimi për shërbimet e ujësjellësit	€/vit	1,389,069
2.8 Arkëtimi për shërbimet e kanalizimit	€/vit	214,102
2.9 Shuma e arkëtimit për dy shërbimet	€/vit	1,603,171
Të dhënat e investimeve kapitale		
3.1 Investimet kapitale për shërbimet e ujit nga burimet vetanake të kompanisë	€/vit	340,000
3.2 Investimet kapitale për shërbimet e kanalizimit nga burimet vetanake të kompanisë	€/vit	43,000
3.3 Shuma e investimeve kapitale vetanake	€/vit	383,000
3.4 Investimet kapitale për shërbimet e ujit nga donatorët	€/vit	445,000
3.5 Investimet kapitale për shërbimet e kanalizimit nga donatorët	€/vit	340,000
3.6 Shuma e investimeve kapitale nga donatorët	€/vit	785,000

ZRRUK edhe gjatë këtij viti do të monitorojë të dhënat e arritura për treguesit kryesor nga kompanitë për të vlerësuar shkallën e përmbushjes së objektivave të përcaktuara të cilat do të publikohen përmes dy raporteve periodike, gjashtë dhe nëntë mujorëve të parë të vitit 2015 dhe atë vjetor pas përmbylljes së vitit biznesor 2015.